


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

83H-7  
M 98

NIKOLLA MULLISI



83H-2

MI P8

NIKOLLA MULLISI

# GOSTIA

— fabula —

20499




SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

## KUSH ËSHTË FAJTORI?

Njëherë gjahtarët,  
bashkë me zagarët,  
të etur për gjah,  
shkuan në pyll;  
e rrighthuan  
në çdo krah  
dhe u betuan  
se s'do të linim kafshë mbi dhe.  
Egërsirat, të alarmuara  
nga kjo gjendje befasie,  
u mblodhën për të diskutuar  
rreth kësaj fatkeqësie.  
Xha ariu, si m'i vjetër,  
foli i pari: — Patjetër  
gjahtarët janë zemëruar,  
bile dhe revoltuar  
nga ujku, që me makutérinë  
e tij, ua shfarosi bagëtinë...

— S'e besoj, — tha ujku  
që pér të gjitha këto unë të jem fajtor  
sepse, fundi i fundit,  
s'jam vetëm unë që i bëj dëm katundit;  
mendoj se tërë kleçka  
qëndron te feçka  
e derrit, që u bie më qafë  
arave të mbjella me misër e patate.  
Atë çast derri kërriti rëndë-rëndë  
— S'duhet të na hidhet faji ne derrave



që ushqehemi vetëm me rrënë e lëndë.  
— Kush pra ka faj? — pyeti ariu i tërbuar. —  
Me sa ma pret kjo rradake, —  
tha derri, — ata janë egërsuar  
me dhëpërën dinake,  
që ua fshiu krejt shpendët shtëpiake.  
— Kjo që thoni, or vëlla,  
është të flasësh badiava,  
sepse ata s'e kanë hallë  
tek ndonjë pulë që u ha  
më të rrallë.  
— Po pse pra na kanë rrëthuar? —  
bërtiti arriu i zëmëruar.  
— Kjo është shumë e qartë, zotëri.  
Ata duan të zënë bilbilin.  
— E përse? — u hodh ariu.  
— Përseja kuptohet vetiu,  
e duan t'u këndoje  
në ndonjë gosti  
kur ata hanë, pinë e ngrenë dolli...

## UJKU DHE QENGJI

Një qengj etjen ishte duke shuar  
në një burim ujëkuluar.

Një ujk i agjëruar që sillej në ato anë  
me barkun zgrop i qaset pranë.

— Si ta turbulosh ujin, që kur u bëre trim? —  
i thotë bisha me tërbim.

— Për trimërinë tënde të kam për të dënuar.

— O mbret, — përgjigjet qengji, — Lartmadhëria  
juaj

gjakun mos ta turbullojë,  
por më mirë le të shikojë  
se pi ujë në vendin tim,  
në burim,


njëzet çapa më poshtë se Ju,  
kështu që s'e kuptoj  
si ujët mund ta turbulloj.

— E turbullon, — i thotë bisha e pamëshirme;  
dhe vitin e kaluar ti më ke sharë një herë.

— Po sì tē paskam sharë, kur ende s'kisha lerë?  
përgjigjet qengji, — unë edhe po pi sisë...

— Në mos ti, vëllai. — Po s'kam asnë.

— Atëhere ndonjë nga tē shtëpisë,  
tha ujku dhe, kur me bisht tē syrit pa



çobanin që ish qasur fare pranë  
me pushkë në duar, i tmerruar, tha:  
— Mos ki frikë, mor budalla,  
unë quesha me ty, bëra shaka —  
dhe iku dalëngadalë  
me bisht ndër shalë.

## GJYSHJA, DALLËNDYSHJA DHE USTAI

Një gjyshe,  
kish dalë në ballkon  
dhe po shikonte një dallëndyshë  
tek ndërtonë  
çerdhen e saj familjare.  
Nën të një usta,  
pa u merakosur fare,  
diç meremetonte me suva.  
Atëhere gjyshja,  
si i pa mirë këta dy ustallarë,  
i tha muratorit: — Çudi, dallëndyshja  
pa çekiç e pa sqepar  
ndërton tërë atë shtëpi  
me goxha rregull e pastërti,  
kurse ju, o të gjorë,  
qofshi suvaxhinj o muratorë,  
edhe për një copë tullë  
na e bëni shtëpinë rrëmullë.


— Mirë bëni, gjyshe, që kritikoni,  
por mos harroni  
(dhe këtë s'e them për shfajësim)  
se ajo shkon vit për vit jashtë  
për specializim.



## QYQJA DHE MËLLËNJA

Kur dëbora maleve shkriu  
dhe pranvera krahët shtriu  
gjer në skutat më të fshehta,  
qyqja mëndjemprehta  
iu lut mëllënjos fqinjë,  
që rrinte aty në një mërqinjë:  
— E dashur mike,  
nga dimëri i sivjetshëm  
dola shumë anemike,  
kështu që edhe atë vezë të vetme  
që pjell, për fat,  
ta ngroh, s'kam takat;  
ndaj të bëj një lutje —  
të vë timen me vezët e tua;  
ishallah kötej e tutje  
për të mirë ta paça hua.  
Mëllenja, kur këto fjalë dëgjoi,  
menjëherë pranoi.

Pasi shkuan disa ditë,  
zogu i qyqes doli në dritë.  
Mëllanjës, kur e pa atë fatkeq  
të qullur e të zhveshur mos më keq,  
iu dhimbs shumë të zezës




dhe vendosi sa më parë  
t'i japë ushqim suplementar.  
Por nuk zgjati shumë kjo dietë,  
sepse zogu i qyqes bukëshkalë,  
me t'u bërë me fletë,  
i flaku tej vezët e mëllanjës së shkretë  
dhe vetë u zhduk në mal.

## HARDHUC A DHE MIU


Dikur, hardhuca dhe miu  
zunë shoqëri  
ashtu vetiu:  
helbete, ishin ngrohur në një diell  
e lagur në një shi.  
Miu menjëherë zuri të ngrinte në qìell  
virtutet e këtij zvarraniku,  
urtësinë, mënçurinë,  
shkathtësinë  
dhe shpejtësinë prej sputniku.  
Hardhuca këto lavdërimë,  
që bëheshin me pekule e nderime,  
s'i honepste fare  
dhe as i besohej,  
por fundi ngushullohej,  
se të tëra ishin pa pare.  
Mirëpo një ditë miu tinzar,  
i njobur si kusar,

befasisht  
e kapi hardhucën mu në bisht  
e i tha; — Mjaft bëmë shaka,  
tani erdhi radha të të ha!  
— Pse? — pyeti hardhuca dhe u step.  
— Sepse ashtu m'u shkrep.  
Hardhuca atëhere  
e mblođhi veten menjëherë  
dhe automatikisht  
këputi një copë bisht  
e ja la në gojë miut;  
pastaj iku e u bë si veriu  
që të mos e shihte kurrë më  
atë turi miu.



## FSHATARI DHE SKIFTERI

Një ditë një fshatari  
i humbi gomari;  
kérkoi sa kérkoi në fqinjë e bot',  
por atë s'e gjeti dot,  
ndaj iu lut skifterit  
veshgjatin t'ia gjente  
dhe iu zotua se, po e gjeti,  
do ta shpërblente  
me një gjel deti,  
U ngrit lart në retë fajkoi,  
pastaj u suall mbi katund;  
kérkoi e kérkoi  
po atë s'e gjeti kurrikund.  
Në kulmin e dëshpërimit,  
fshatari,  
dëgjoi të pëlliste  
gomari,  
Ai birçja paskish qenë rrasur



prapa një mullari.

Atëhere fshatari i tha

skifterit: — Si shpjegohet, o kumbar,

që ti nga lartësira tepër të mëdha

sheh botën mbarë:

zogun e kloçkës, miun,

zhapiun,

lepurushin

dhe s'sheh veshllapushin?

Në vend të skifterit foli një zogjth

sa një toph:

— Ky, mor, të gjetë e mira,

s'merret, siç e dinë disa,

me gjëra të mëdha,

po me vogëlsira.

—  
—  
—  
—  
—  
**KROI DHE PËRROI**  
—  
—  
—  
—  
—  
—  
—

Një ditë pérroi shkoi te kroi  
e i tha:  
— Dëgjo këtu, vëlla,  
pak ujë dua,  
hua,  
se vera që sivjet e gjatë  
dhe shum' e thatë...  
— Dëgjo këtu, përrua:  
më do dhe të dua;  
kemi një nënë, një baba;  
si më të moshuar  
gjithmonë të kam dëgjuar;  
por kur ti turre me furtunë  
e rrapiellimë,  
kur merr e shpie në lumë  
ndonjë lëndinë,  
një pemë, një lopë e një ka,  
s'honepse dot, vëlla!

Sharjet, mallëkimet,  
lotët, rënkimet  
veç unë i dëgjoj,  
se ti atëhere bëhe thumb  
edhe logjikën humb.  
Fshatarët ta kanë bërë benë,  
do të ta lozin fenë...  
Ha, ha, ha! — qeshi përroi, —  
mua,  
që jam goxha përrua!..  
— Mos u habit aspak, — tha kroi, —  
dëgjo vëllanë;  
se do të gjesh belanë;  
ata po hapin goxha male,  
ndërtojnë hidrocentrale  
dhe po bëjnë zap shumë lumenj  
me krahët fuqiploë,  
që janë më të mëdhenj  
se sa zotria jote.

## MERIMANGA DHE TEZGJAISTJA

Merimangës iu shkrep një ditë  
të shkojë në një kombinat  
tekstilesh,  
jo për të marrë zanat,  
po për një vizitë.  
Hyri n'oborr, pastaj në fabrikë,  
atje ku maqinat punonin  
me zhurmë sa të shurdhonin;  
hodhi sytë përreth me frikë  
dhe pyeti: — Ku është pëlhura?  
— Këtu është filatura —  
i tha një vajzë punëtore,  
e veshur me të bardha, si top dëbore.  
— Këtej bëhet fije-fije pambuku,  
pastaj kalon nëpër ca tuba kauçuku  
e lidhet ndër masurë;  
andej futet në tezgjah,  
ku rrihet shpejt dhe pa krah'

dhe... bëhet pëlburë.

Merimanga me këto që pa duke shetitur,  
mbeti shumë e mahnitur.

— Nuk më thua, shoqja punëtore,  
përse duhen tërë këto marifete?


Sepse unë për vete,  
që end si ju pëlburë,  
nuk kam nga këto që pashë,  
tezgjah, ngjyrosje, filaturë  
e më the të thashë;  
kam një mekanizëm të thjeshtë fare,  
që e kam marrë thuajse pa pare,  
kurse ju, o motra ime,  
bëkërk shumë shpenzime.

Tezgjaistja ia ktheu aty për aty:

— Ne prodhojmë pëlburë,  
kurse ju merimangat  
cerga në murë.

## ZONJA ANTIGONI DHE PRESHTË

Dy tufa me presh  
në mes tyre u morën vesh,  
kur u takuan në pazar,  
të dilnin nëpër qytet  
për të parë  
ndonjë kuriozitet;  
kështu brodhën sa brodhën,  
der' sa u lodhën.  
Por, fundi,  
kot s'u vajti mundi.  
Panë shumë gjëra të mrekullueshme,  
bile, disa të pabesueshme;  
mbi të gjitha, panë zonjën Antigoni  
se si që lart nga ballkoni  
i përshëndeti këta mysafirë  
me një legen me ujë të këllirë.  
— Kujdes, zonjë, jo gjë tjetër,  
pak respekt për këtë mjekër, —



thanë preshtë. Por zonja Antigoni  
përsëri që nga ballkoni  
miqt' i kënaqi  
me një legen tjetër plehrash  
dhe bishtrash spinaqi.

— O burra t'ikim, — thanë tufat me  
presh, —  
se mos kushedi zonja Antigoni,  
qoftë larg nesh,  
hidhet edhe vetë nga ballkoni,  
pastaj ec e merru vesh.

## GOMARJA DHE MUSHKA

Gomarja, që në dasmë ish thirrë  
të mbarte ujë për të pirë,  
padashur, njëherë,  
kur i shkau këmba  
le që theu tër'ato shtëmba,  
po desh ra dhe në humnerë.  
Erdhën në vendin e ngjarjes plot  
dhe panë se gomarja s'ngrihej dot.  
Një mushkë, që kulloste në lëndinë,  
s'kujohej fare t'i vinte në ndihmë.  
Gomarja, pa masë e inatosur,  
thirri si e xhindosur:  
— Tundu vendit, moj shushkë.  
Të linda, të rrita, të bëra mushkë,  
më ke nënë, jam gomarja!  
— Gomarllëqe! —  
gjegji mushka, —

sht, mos. tē tē dēgjojë krushka.  
Kush ta ka futur nē kokë,  
këtë gënjeshtër me okë?  
Unë, oj tungjatjeta, s'pëllas që me natë,  
as jam veshgjatë,  
as merrem nëpër gojë,  
as vihem nē lojë,  
unë jam ajo që jam,  
po ty nënë s'të kam.  
Ata që e dëgjuan,  
u munduan  
t'a bindnin atë kokëngjeshur,  
po mushkës i hypi,  
s'i mbushej që s'i mbushej qypi.  
— Lëreni kokëshkretën! —  
thirri më në fund veshgjati.  
Dikur ajo e krisur  
do ta gjejë belanë.  
Dhe vërtet një ditë,  
siç u muar vesh,  
ajo e kishte gjetur ustani.  
Gomarja, kur e pa  
se mushka ishte bërë lëre mos e nga,  
tha urtë e butë:  
— Hajt, se kështu i do mushka drutë.

## SPORTELISTI DHE KRIMBI I MËNDAFSHIT

- Edhe një herë emrin, si e thatë? —  
pyeti sportelisti  
një klient të gjatë e të thatë.
- Krimb — gjegji klienti nga salloni.
- Dree, të mora për basketballist!  
Profesioni?
- Punëtor mëndafshi.
- Ku punon, në ç'fabrikë?
- Në një fshikzë.
- Bëheni shumë punëtorë?
- Jo, vetëm unë.
- Ç'thua, si mund të punojë një njeri  
i vetëm, pa shoqëri?!  
Nejse, ç'urdhëron?
- Një dhomë më vete, mundësish  
të jetë e mënjanët,  
pa penxhere e ballkon,  
e mbyllur hermetikisht


në té katér anët.

— Si, ore, si? Qenke torovel.

S'e ditkérke që këtu èshtë hotel?

— E di si urdhëron!

— Atëhere ç'kérkon?



— Një dhomë si e di ti, —  
dhe i shkeli njërin sy.

— Mirë — tha sportelisti, —  
do ta rregullojmë dhe një vend për ty  
veç, më qafsh!  
Mos harro të më ruash  
tri metra mëndafsh.

## GOMARI DHE BAGËTIA

Mëngjez.

Dielli ngrihet mbi mal,  
përkedhel lulet e ngarkuara me vesë.

Zgjohet bagëtia,  
shpeshëria,

pastaj dalëngadalë  
edhe fshatarësia.

Këndezi ja nis i pari,  
pastaj me radhë, lopa, delja, dhia  
dhe tërë shpeshëria.

Blegërimat dhe pëllitjet  
tundin shtallën,  
shtalla — mëhallën,


mëhalla — fshatin që përtërihet.

Një gomar, që akoma i flihet,

ngrihet rrëmbimthi

dhe duke fërkuar duart me hare  
me shpresë të ndonjë katastrofe  
ngjitet në shtallë

për të parë  
se çfarë ka ngjarë.  
— Ç'kini, o të uruar! —  
u thotë gomari bagëtisë, —



jini tērbuar  
apo e mira ju ka harlisë.  
Ndonjëri,  
q'e ka nē majë tē gjuhës kritikën,  
kujton se stallieri  
ju ka ngulur thikën.  
Qeshën bagëtitë, ha, ha, ha!  
— Pika që s'të ra,  
ne blegërijmë e pëllasim  
që, jo vetëm tē pëlcasin  
ujqit, çakejtë e tē tjerë,  
por edhe sepse sot, ne  
gëzojmë jetën  
në stallën e re.  
«Lum si ju, tha gomari me vete,  
mbi ne gomarët vlon akoma huri —  
le po tani na kanë nxjerrë  
dhe nga hauri.»

## PULA DHE VEZA


Pula dhe veza  
haheshin përditë  
se cila nga ato  
kish dalë në dritë  
e para.

Pula thosh: — Unë të bëra ty,  
veza thosh: — Unë të bëra ty.  
— C'keni që ziheni, o të uruara, —  
u tha një ditë gjeli,

pendëshkruar.


I tha pula: — A nuk më thua,  
veza më bëri mua,  
apo unë vezën?

Gjeli, pa u menduar shumë,  
tha: — Pse e diskutoni këtë punë?  
Vezën e bëra unë.



## DHELPËRA DHE SHPESHËRIA


Shpeshëria e furriqeve dhe qymezëve  
ftuan njëherë për darkë  
dhelprën plakë;  
krahas darkës, pijeve dhe mezeve  
ata ngritën aty përqark  
një goxha çark,  
kështu që kjo grackë  
do të qe një dackë  
për dhelpërën mëndjeprehtë;  
ta mbante vath në vesh  
për jetë.  
Shpeshëria e pritën atë natë,  
të nesërmen,  
të pasnesërmen,  
por kaloi një kohë e gjatë  
dhe krushka s'vinte aty,  
s'dukej fare me sy.  
Duket se ajo e pabësë



i kish rënë hilesë.  
Shpeshëria pritën sa pritën  
gjersa u mërzitën,  
pastaj çarkun e shkrehën dhe u larguan,  
mendjen e fjetën dhe e harruan.  
Mirëpo një natë, në shi e në furtunë,  
kur jo vetëm shpeshëria,  
por edhe njerëzia  
flinin e bënin gjumë,  
dhelpra «mysafirja»  
hyri në qymez  
serbes-serbes  
dhe një nga një i rrëmbëu,  
i zhduku dhe i shqeu.

## QENI DHE MAÇOKU

Se sa shkojnë maçoku dhe qeni,  
këtë s'është zor ta themi,  
pasi, në të vërtetë,  
ju i njihni vetë.  
Grindjen gjithmonë i pari e ndez  
babloku;  
mirëpo, një mëngjez  
ndodhi ndryshe. Maçoku  
kish zënë një mi  
dhe po e tororiste në gojën e tij.  
Qeni që e pa këtë skenë, u revoltua,  
por për të mos e zemëruar,  
i tha dacit me zë atëror:  
— Lëshoje të shkretin, mos u bën mizor!  
Ç'të bëri, o ditëzi,  
të ngau,  
të shau?  
S'ia vlen të merresh me një mi.



Pa le një ditë si bie lota,  
s'dihet, bota është me rrota.

Mirëpo maçoku, që e dinte mirë  
se ai lehte kot nën zinxhirë,  
më s'priti,

po dacërisht miun kullufiti.

Një natë rastisi që nëpër avlli  
këcyen ca kusarë

dhe hynë në shtëpi

për të vjedhur, sigurisht.

Qeni, që rrinte vazhdimesht  
në përgjim,

nisi të lehte me tërbim.

Maçoku, kur e pa se kolegu po çirrej,

i tha: — Ç'është tërë ky zemërim,  
o vëlla, dhe ku është parë

që qentë të merren me kusarë?

Pa le një ditë si bie lota,  
s'dihet, bota është me rrota.

Qeni s'e kuptoi romuzin, s'e zgjati,  
por bëri ashtu si ia donte zanati.

## G O S T I A

Dhelpëra,  
që njihet për dhelpëri,  
njëherë na propozoi  
të ftoj'  
për darkë  
tërë kafshët dhe shpendët.  
— Si thoni? — u pleqëruan  
shtëpiakët. — Vemi a s'vemi?  
— Të vemi, të vemi —  
ia priti gomari, që hiqeji si m'i zoti, —  
të mblidhemi një herë si qëmoti  
pa dallim race, sekzi, lloji  
dhe soji.  
Erdhi dita e u mblozhën  
dhe hodhën  
në diskutim  
një projektvendim



mbi mënyrën e organizimit  
të gostisë, ushqimit, dëfrimit...  
I pari u ngrit ariu e tha:

— Mua për meze më mjafton një ka  
dhe një zamzanë me verë.  
Pastaj u ngrit ujku menjëherë:

— Unë për vete, propozoj në radhë të parë  
të therim ca dele, qengja e gomarë.

— Kështu, or byrazer, — ia priti dhëlpëra —  
hesapi s'na del.

Unë nga ana ime  
them të mos bëjmë shumë shpenzime.  
Në këtë gosti,  
mjafton të kemi për meze nga një gjel  
dhe një gotë raki.

— Po të merrnim mend' e tua. —  
tha çakalli, —  
vaj halli!


E ku na del  
ne mezeja me nga një gjel?  
Do hamë e do pimë, o e gjorë,  
s'kemi nge të mbajmë barkun me dorë.

Shtëpiakët,  
që n'atë «mexhiliz» ishin më të pakët,  
sy ndër sy u panë  
edhe thanë:

— C'deshëm që morëm mendt' e gomarit,  
ramë e u mpleksëm me këtë shoqëri  
të hurit e të litarit, —  
dhe ikën e u shpërndanë,  
shoshoqin më s'e panë.

## PLEPI DHE MOLLA

Një mollë dhe një plep  
lindën në një ditë bashkë  
dhe u tundën në një djep  
si dy binjakë;  
bashkë u rritën këta dy fidanë,  
të mirat dhe të ligat  
bashkë i ndanë.  
Por ku mbaruan shkollën,  
plepi filloi ta kaloj' mollën;  
hodhi shtat, u rrit goxha,  
trupi tij shkoi n'hava.  
Paskëtaj harroi shokun e fëminisë,  
harroi lodrat, djepin, ninullat e foshnjërisë;  
dhe pastaj askujt s'i fliste  
se çfarë bënte e ç'nanuriste  
atje lart tok me erën.  
Kaloi dimri, erdh pranvera,  
molla u mbush me burbuqe,



në vjeshtë, me kokrra të kuqe:  
mollë të kuqe dhe të mëdha,  
për sevda.

Këtë plepi kur e pa,  
i tha mollës si me shaka:  
— Mos u bëj e pabesë,  
mos më lerë mua pa pjesë.

Mirëpo molla që ia njohu karakterin,  
besën, burrërinë dhe nderin,  
asnje kokërr nuk i dha,  
as lëkurat nuk ia la.

## UNË DHE PAPAGALLI

Një shoku im  
mbante një papagall në shtëpi,  
ashtu kot, për stoli.  
Ai shpend mjaft i zgjuar  
e kishte mësuar  
emrin tim  
dhe, sa herë që shkoja tek ai,  
në kafaz,  
përsëriste pa pushim  
të njëjtin avaz:  
Gim, Gim, Gim!  
Kisha disa muaj  
pa vajtur te shoku im,  
por ai i mallkuar  
nuk më kish harruar  
dhe, sa më pa,  
nisi të përsëriste pa pushim

emrin tim:  
Gim, Gim, Gim!  
Qesha dhe m'u kujtua atças,  
shoku Anastas,  
që në çdo mbledhje profesionale  
bluante të njëjtin avaz —  
tamam si papagalli  
në kafaz.

## BLETA DHE PLESHTI

Bleta punëtore,  
e dhënë pas punës aty te zgjoi,  
e harroi  
dhe la pas dore  
takimin me pleshtin.  
Një ditë ajo i çoi fjalë  
e i la takim  
mu te ura në të dalë.  
— Më kishit kërkuar? —  
pyeti pleshti, me një kërcim  
pa kuptim.  
— Diku kam lexuar,  
nëpër gazeta, —  
e hapi bisedën bleta, —  
se ma qenke atlet i shkëlqyeshëm;  
nuk di sa janë të vërteta.  
— Jo vetëm aq, — tha pleshti i papërtueshëm, —  
por dhe kërcimtar  
i kategorisë së parë.

Bile, në kërcim me një hap,  
o zonja bletë,  
mendja ma thotë  
s'ma kalon atlet  
në botë.

— Vërtet?! Urime, përgëzime  
nga ana ime!

Ti me këto cilësira  
bën çudira  
S'marr vesh përse  
kërcen kurri më kurri  
e më shitet  
si parazit?!

---

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Kush është fajtori? .....	3
Ujku dhe qengji .....	6
Gjyshja, dallëndyshja dhe ustai .....	9
Qyqja dhe mëllënja .....	11
Hardhuca dhe miu .....	14
Fshatari dhe skifteri .....	16
Kroi dhe përroi .....	19
Merimanga dhe tezgjaistja .....	21
Zonja Antigoni dhe preshtë .....	23
Gomarja dhe mushka .....	26
Sportelisti dhe krimbi i mëndafshit .....	28
Gomari dhe bagëtia .....	31
Pula dhe veza .....	34
Dhelpëra dhe shpeshëria .....	36
Qeni dhe maçoku .....	39
Gostia .....	41
Plepi dhe molla .....	44
Unë dhe papagalli .....	47
Bleta dhe pleshti. ....	49

**Redaktor: RAMAZAN VOZGA  
Piktor: BARDHYL FICO**

---

**Tirazhi 3.000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72**

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «3 NËNTORI» — Tiranë, 1974